

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Efikasiteti i procedural dhe të drejtat e njeriut në procedurën penale
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	2021/22
Numri i orëve në javë:	3 + 1
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	E enjte 16.00 – 18.30
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.Azem Hajdari
Detajet kontaktuese:	Viti I
Përshkrimi i lëndës	<p>Studimi lëndës mësimore: “Efikasiteti i procedurës penale dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut”, bashkë me studimin E të drejtës së procedurës penale dhe E të drejtës së procedurës penale të veçantë e të cilat studiohet në studimet themelore dhe degëve të tjera juridike nga lëmi juridiko penal, studentëve u afrohet njohuri vijuese teorike dhe praktike në luftë të suksesshme kundër kriminalitetit, e cila rezulton me shqiptimin dhe ekzekutimin e sanksionit penal ndaj kryerësit përgjegjës të veprës penale. Mirëpo, për të realizuar qëllimin e procedurës penale duhet që të zbatohet një aktivitet i dendur dhe efikas i organeve shtetërore (policisë, prokurorisë, gjykatës), në mënyre që asnjë kryerës përgjegjës të mos mund t’i bishtnojë përgjegjësisë penale duke ofruar njëkohësisht garanci që asnjë person i pafajshëm të mos dënohet. Për të pamundësuar dënimin e personit të pafajshëm në procedurat penale bashkëkohore të pandehurit i njihet e drejta e gjerë në mbrojtje nga veprimet e mundshme arbitrare të organeve shtetërore. Prandaj është e domosdoshme që studentët nëpërmjet kësaj lënde më tutje t’i thellojnë njohuritë e tyre specializuara nga lëmi juridiko penal dhe të përgatitën për zbatimin e tyre në praktikë.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Për të realizuar me sukses qëllimin e procedurës penale duhet që të zbatohet një aktivitet i dendur dhe efikas i organeve shtetërore (policisë, prokurorisë, gjykatës), në mënyre që asnjë kryerës përgjegjës të mos mund t’i bishtnojë përgjegjësisë penale duke ofruar njëherësh garanci që asnjë</p>

	<p>person i pafajshëm të mos dënohet. Mirëpo, për të pamundësuar dënimin e personit të pafajshëm në procedurat penale bashkëkohore të pandehurit i njihet e drejta e gjerë në mbrojtje nga veprimet e kundërligjshme dhe arbitrare të organeve shtetërore. Prandaj, studentet në kuadër të kësaj lënde duke fituar njohuri specifike nga lëmi penal procedural, më tutje thellojnë njohuritë e tyre specializuara për të zbatuar më sukses dhe në mënyrë të drejtë dispozitat e të Drejtës së procedurës penale në praktikën gjyqësore.</p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi të thelluar të studimeve në studimet e Programit Master, synohet që studenti:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të kuptojë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e ekzistimit të tendencës për efikasitet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në procedurës penale, - të thellojë njohuritë lidhur me dispozitat e procedurës penale që kanë të bëjnë para së gjithash me zbulimin, ndjekjen dhe shpalljen fajtor të kryerësit të përgjegjshëm të veprës penale, - të analizojë në veçanti dispozitat me të cilat sigurohet mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut para se gjithash të personit kundër të cilit zhvillohet procedura penale dhe subjekteve të tjerë procedural, - të mësojnë për arsyet e ekzistimit të tendencës për efikasitet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe kërkesës që ndërmjet këtyre tendencave të arrihet baraspeshaekulibri. - të aftësohen që këto dispozita t'i interpretojnë drejtë dhe me konsekuencë t'i zbatojnë praktikën gjyqësore. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	13	13
Punë praktike	1	5	05
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	05
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume, seminare	5	5	25
Detyra të shtëpisë	5	5	25

Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	10	10
Projektet,prezentimet ,etj	1	10	10
Totali	22	98	198
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënies së lëndës do të përfshijë, ligjërata, debate-diskutime dhe hartim të seminareve. Gjatë debateve studentet duhet ushtrohen që ndaj çështjeve që diskutohen të marrin qëndrim të pavarur dhe kritik dhe të propozojnë zgjidhje dhe alternativa të reja.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi I studentëve do të bëhet përmes zbatimit të këtyre metodave: 1.Provimeve, 2. Kolokviumeve, 3.Prezantimeve, 4.Punimeve seminarike, 5.Pjesëmarrjes në debate, 6.Zgjidhjes së rasteve praktike etj.		
Literatura			
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - Hajdari Azem, Efikasiteti procedural dhe të drejtat e njeriut në procedurë penale, Prishtinë, 2011. - Hajdari Azem, E drejta e procedurës penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2014. - Hjadari Azem, E drejta e procedurës penale, Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2013. - Hjadari Azem, Kodi i procedurës penale, Komentar, Prishtinë, 2016. - Hajdari Azem, Shkathësitë e praktikës gjyqësore, Prishtinë, 2013. - Sahiti, Ejup, Murati Rexhep, E drejta e procedurës penale, Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës, 2013. - Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentar i Kodit të procedurës penale, 2014. 		

<p>Literatura shtesë:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Sahiti Ejup, Argumentimi në procedurën penale, Prishtinë, 2006. - Krapac Davor i suradnici, Kazнено procesno pravo, Primjerovnik, Zagreb, 2001. - Krapac Davor, Kazнено procesno pravo, libri i parë: institucije, botim i dytë i ndryshuar dhe i plotësuar, Narodne Novine d.d, Zagreb, 2010. - Pavišić Berislav, Komentar Zakona o kaznenom postupku,, Rijeka, 2013. - Sijerčić-Čolić Hajrija, Krivično procesno pravo, knjiga I, Krivičnoprocesni subjekti i krivičnoprocesne radnje, Pravni fakultet Univerziteta u Sarajevu, Sarajevo, 2008. knjiga II, Tok redovnog krivičnog postupka i posebni postuci, Pravni fakultet Univerziteta u Sarajevu, Sarajevo, 2008. (1. janar 2013); - Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale (UNMIK, Rregullorja nr. 2003/26, datë 6 korrik 2003, ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004); ndryshimet dhe plotësimet –Ligji Nr. 03/ L-003 të datës 6 nëntor 2008. - Kodi penal i Republikës së Kosovës (1 janar 2013) . - Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (UNMIK, Rregullorja nr. 2003/25, datë 6 korrik 2003), ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004; ndryshimet dhe plotësimet . –Ligji Nr. 03/ L-002 të datës 6 nëntor 2008. - Kodi i drejtësisë për të mitur i vitit 2010. -Ligji penal për të miturit i Kosovës (UNMIK, Rregullorja nr. 2004/8 datë 20 prill 2004) ka hyrë në fuqi të njëjtën ditë. - Rregullorja për kryerësit e v.p. me çrregullime mendore (UNMIK, Rregullorja nr. 2004/34, datë 24 gushtë 2004) ka hyrë në fuqi të njëjtë ditë . - Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale i vitit 2010. - Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale i Kosovës (UNMIK, Rregullorja nr. 2004/46, datë 19 nëntor 2004) ka hyrë në fuqi me 19 shkurt 2005 - Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut e vitit 1948 Universal Declaration on Human Rights, G.A.res. 217 A(III), U.N. Doc. A/810 at 71 -Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike me protokollet e vitit 1966 International Covenant on Civil and Political Rights, G.A. res.
----------------------------------	--

	<p>2200A (XXI), 21 U.N. GAOR Supp. (No.16) at 52, U.N. Doc. A/6316 (1966), 999 U.N.T.S. 171, entered into force Mar. 23, 1976.</p> <p>- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturor i vitit 1966 International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights G.A. res. 2200A (XXI), 21U. N. GAOR Supp (No.16) at 49, U.N. Doc. A/6316 (1966), 993 U.N.T.S. 3, entered into force Janeni 3, 1976.</p> <p>- Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriute vitit 1950, me protokollet shtesë European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms, (ETS No. 5), 213 U.N.S. 222, entered into force Sept. 3,1953, as amended by Protocols No 3, 5, 8, i 11 ëhich enterd into force on 21 September 1970, 20 December 1971, 1 January 1990, and 1 November 1998 respectively.</p>
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	<p>Njohuritë themelore mbi tendencën për efikasitet procedural dhe të drejtat e njeriut në procedurën penale.</p> <p>Kuptimi i tendencës për efikasitet [procedural penal dhe të drejtat e njeriut në procedurën penale në përgjithësi, në Kosovës dhe disa vende të tjera.</p> <p>Efikasiteti procedural dhe të drejtat e njeriut në procedurë penale gjatë zhvillimit historik të procedurës penale – tipin akuzator, inkuizitor dhe të përzier të procedurës penale.</p>
Java e dytë:	<p>Efikasiteti procedural dhe të drejtat e njeriut në lidhje me masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale: thirrjen gjyqësore, urdhërarrestin, premtimin e të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin dhe ndalimin për tui afruar vendit apo personit të caktuar.</p>
Java e tretë:	<p>Efikasiteti procedural dhe të drejtat e njeriut në lidhje me masat e sigurimit të pranisë së të pandehurit në procedurën penale: paraqitjen në stacionin policor, dorzaninë dhe arrestin shtëpiak.</p>
Java e katërt:	<p>Efikasiteti procedural dhe të drejtat e njeriut në lidhje me masat e sigurimit të pranisë së të pandehurit në procedurën penale: diversionin dhe paraburgimin</p>
Java e pestë:	<p>Efikasiteti procedural penal dhe të drejtat e njeriut në procedurën penale në lidhje me masat për sigurimin e provave materiale dhe të interesave pasurore: kontrollimin dhe këqyrjen e rikosntruksionin e vendit të ngjarjes.</p>

Java e gjashtë:	Efikasiteti procedural penal dhe të drejtat e njeriut në procedurën penale në lidhje me masat për sigurimin e provave materiale dhe të interesave pasurore: masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit dhe identifikim të sendeve e personave.
Java e shtatë:	Efikasiteti procedural penal dhe të drejtat e njeriut në procedurën penale në lidhje me provat: kuptimin e provës, objektin e të provuarit, barrën e provës.
Java e tetë:	Efikasiteti procedural penal dhe të drejtat e njeriut në procedurën penale në lidhje me marrjen në pyetje të të pandehurit, marrjen në pyetje të dëshmitarit dhe marrjen në pyetje të ekspertit.
Java e nëntë:	Efikasiteti procedural penal dhe të drejtat e njeriut në procedurën penale në lidhje me statet e procedurës penale: procedurën paraprake, gjatë ushtrimit të autorizimeve të policisë dhe zbatimit të hetimit.
Java e dhjetë:	Efikasiteti procedural penal dhe të drejtat e njeriut në procedurën penale gjatë ngritjes së aktakuzës dhe shqyrtimit të saj.
Java e njëmbëdhjetë:	Efikasiteti procedural penal dhe të drejtat e njeriut në procedurën penale gjatë shqyrtimit gjyqësor: fazës së fillimit të shqyrtimit gjyqësor, procedurës së administrimit të provave dhe fjalës përfundimtare të palëve.
Java e dymbëdhjetë:	Efikasiteti procedural penal dhe të drejtat e njeriut në procedurën penale në ndërlidhje me mjetet juridike.
Java e trembëdhjetë:	Efikasiteti procedural penal dhe të drejtat e njeriut në procedurën penale në ndërlidhje me procedurat alternative.
Java e katërbëdhjetë:	Efikasiteti procedural penal dhe të drejtat e njeriut në procedurën penale në ndërlidhje me procedurën penale për të mitur.
Java e pesëmbëdhjetë:	Efikasiteti procedural penal dhe të drejtat e njeriut në procedurën penale në ndërlidhje me procedurat penale të posaçme.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p>Përmes punës me student do të arrihet në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Avancimin e dijes, ideve kreative dhe shkencës, 2. Avancojë zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës, shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës; 3. Ndhimohet në procesin e promovimit të demokracisë qytetare; 4. Krijimin dhe mbështetjen e standardeve më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësim nxënies si dhe kërkimeve shkencore; 5. Zhvillimin e personalitetit të shëndoshë dhe kreativ etj.

